



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

U D H Ë Z I M

Nr. _____, datë _____.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR IDENTIFIKIMIN,
DEKLARIMIN, SHQYRTIMIN DHE MENAXHIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESIT GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË LOBIMIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 20 të ligjit nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”),

U D H Ë Z O N:

1. Ky udhëzim ka për qëllim:
 - a) përcaktimin e procedurave për identifikimin, deklarimin, shqyrtimin dhe menaxhimin e situatave të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lobimit, me synim garantimin e integritetit të lobistit, zyrtarit publik dhe institucionit publik;
 - b) garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së lobimit në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente, në interes të publikut dhe për rritjen e besimit ndaj institucioneve publike.
2. Për identifikimin e situatave të konfliktit të interesit merren në konsideratë, sipas rastit:
 - a) anëtarët e familjes, duke iu referuar, me përshtatjet përkatëse, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es, fëmijëve madhorë dhe personave të afërt deri në shkallën e dytë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike;
 - b) lidhjet ekonomike, për vlerësimin e të cilave merren në konsideratë, me përshtatjet përkatëse, të drejtat dhe detyrimet pasurore, interesat financiarë, pjesëmarrja në kapital ose interesa të tjerë pronësorë në persona juridikë, marrëdhëniet tregtare, si dhe marrëdhënie të tjera me natyrë ekonomike, që krijojnë përfitim ose interes ekonomik ndërmjet personave të përfshirë, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike;
 - c) lidhjet profesionale, për vlerësimin e të cilave merren në konsideratë, me përshtatjet përkatëse, marrëdhëniet profesionale ose të punës, formale ose joformale, që ekzistojnë ose kanë ekzistuar brenda 2 (dy) viteve të fundit, në

përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 3, pika 24, të ligjit nr. 23/2026 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;

- ç) lidhjet kontraktore, për vlerësimin e të cilave merren në konsideratë, sipas rastit, marrëdhëniet kontraktore ndërmjet personave të përfshirë, që ekzistojnë ose kanë ekzistuar brenda 2 (dy) viteve të fundit, si dhe objekti i tyre.

Në vlerësimin e rrethanave të parashikuara, në këtë pikë merren në konsideratë, sipas rastit, natyra, intensiteti, kohëzgjatja dhe lidhja e tyre me veprimtarinë konkrete të lobimit, për të përcaktuar nëse ato mund të ndikojnë në paanshmërinë dhe objektivitetin e ushtrimit të kësaj veprimtarie. Vlerësimi kryhet në përputhje me Ligjin dhe, për aq sa është i zbatueshëm, me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

3. Përpara lidhjes së kontratës së lobimit, lobisti verifikon, mbi bazën e informacionit që disponon dhe duke vepruar në mirëbesim, nëse ekziston ndonjë rrethanë që mund të përbëjë konflikt interesi sipas nenit 20 të Ligjit. Kur, si rezultat i këtij verifikimi, konstaton ekzistencën e një konflikti interesi, lobisti njofton përfituesin e lobimit dhe nuk lidh kontratën.
4. Në rastet e mëposhtme, lobisti vepron si vijon:
 - a) nëse konflikti i interesit konstatohet pas lidhjes së kontratës së lobimit, njofton menjëherë përfituesin e lobimit dhe Komisionerin, si dhe heq dorë nga ushtrimi i veprimtarisë së lobimit, duke ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e marrëdhënies kontraktore, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) nëse përfaqëson ose angazhohet për dy ose më shumë përfitues lobimi me interesa të kundërta në të njëjtën çështje, në kuptim të pikës 2 të nenit 20 të Ligjit, refuzon lidhjen e kontratës ose heq dorë nga ushtrimi i veprimtarisë së lobimit në çështjen përkatëse, njofton me shkrim përfituesin ose përfituesit e lobimit dhe, kur kontrata është lidhur, njofton edhe Komisionerin.
5. Në rast dyshimi mbi ekzistencën e një konflikti interesi, lobisti mund t’i drejtohet Komisionerit për orientim mbi zbatimin e këtij udhëzimi.
6. Për çdo kontratë lobimi të lidhur, lobisti paraqet pranë Komisionerit, brenda afatit të parashikuar në Ligj, deklaratën për mungesën e konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 13, pika 1, shkronja “c”, dhe nenin 20 të Ligjit.
7. Njoftimi për heqjen dorë nga ushtrimi i veprimtarisë së lobimit për shkak të konfliktit të interesit bëhet me shkrim, përmban arsyet e heqjes dorë dhe i paraqitet Komisionerit dhe përfituesit të lobimit.
8. Njoftimi i Komisionerit për konfliktin e interesit, në rastet e parashikuara në pikën 4 të këtij udhëzimi, bëhet me shkrim në një nga mënyrat e mëposhtme:
 - a) nëpërmjet sistemit elektronik të Regjistrimit të Lobimit;
 - b) në formë elektronike (e-mail), në adresën elektronike zyrtare të Komisionerit;
 - c) nëpërmjet shërbimit postar;
 - ç) fizikisht pranë zyrës së protokollit të Komisionerit.
9. Njoftimi i parashikuar në pikën 8 të këtij udhëzimi bëhet sipas formularit të Aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
10. Çdo person që ka dijeni për rrethana që mund të përbëjnë konflikt interesi sipas nenit 20 të Ligjit, përfshirë rastin kur lobisti përfaqëson ose angazhohet për dy ose më shumë përfitues lobimi me interesa të kundërta në të njëjtën çështje, mund të njoftojë

- Komisionerin në një nga mënyrat e përcaktuara në pikën 8 të këtij udhëzimi. Njoftimi mund të paraqitet edhe në mënyrë anonime, nëse kjo nuk pengon shqyrtimin e tij.
11. Komisioneri fillon procedurën administrative për verifikimin e konfliktit të interesit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e deklaramit ose njoftimit sipas këtij udhëzimi.
 12. Procedura administrative sipas pikës 11 të këtij udhëzimi mund të iniciohet:
 - a) me marrjen e deklaramit të lobistit;
 - b) me marrjen e njoftimit të çdo personi sipas pikës 10 të këtij udhëzimi;
 - c) me nismën e Komisionerit, mbi bazën e fakteve ose informacionit të siguruar nga burime të ligjshme;
 - ç) në rastet e tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
 13. Për qëllime të verifikimit, Komisioneri mund të konsultojë regjistrat publikë dhe burimet e tjera zyrtare të informacionit, si dhe të bashkëpunojë me autoritetet kompetente, në përputhje me kompetencat e parashikuara në Ligj.
 14. Kur gjatë verifikimit konstatohen indicie për shkelje të Kodit të Sjelljes në lidhje me konfliktin e interesit, Komisioneri vijon procedurën nëpërmjet zhvillimit të hetimit administrativ, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe Ligjin.
 15. Në përfundim të procedurës së hetimit administrativ, nëse konstaton se lobisti ka shkelur Kodin e Sjelljes në lidhje me konfliktin e interesit, Komisioneri merr vendim të arsyetuar dhe vendos masën administrative të parashikuar në nenin 24, shkronja “ë”, të Ligjit.
 16. Vendimi i Komisionerit u njoftohet me shkrim lobistit dhe çdo pale tjetër të përfshirë në procedurën administrative, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.
 17. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen lobisti, përfituesi i lobimit, struktura përgjegjëse pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe çdo zyrtar publik që ushtron funksione publike, funksione vendimmarrëse ose këshilluese në autoritetin publik të përfshirë në veprimtarinë e lobimit, sipas Ligjit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

ANEKSI NR. 1

FORMULAR: DEKLARIM PËR KONFLIKTIN E INTERESIT GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË LOBIMIT

Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. ____/2026 “Për përcaktimin e procedurave për identifikimin, deklarimin, shqyrtimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lobimit”.

I. TË DHËNAT E LOBISTIT

Emër / Emërtim

Numri i regjistrimit në Regjistrin e Lobimit

☐ Person fizik

☐ Person juridik

Nëse është person juridik:

Përfaqësuesi ligjor

II. LLOJI I DEKLARIMIT

☐ Deklarim për konflikt interesi të konstatuar pas lidhjes së kontratës së lobimit

☐ Deklarim për përfaqësimin ose angazhimin për dy ose më shumë përfitues lobimi me interesa të kundërta në të njëjtën çështje, sipas nenit 20, pika 2, të Ligjit

III. TË DHËNAT MBI VEPRIMTARINË E LOBIMIT

Çështja ose tema e lobimit

Përfituesi i lobimit

Autoriteti publik ndaj të cilit ushtrohet veprimtaria e lobimit

IV. RRETHANAT QË MUND TË PËRBËJNË KONFLIKT INTERESI

Konflikti i interesit lidhet me:

- ☐ Anëtarët e familjes
- ☐ Lidhje ekonomike
- ☐ Lidhje profesionale
- ☐ Lidhje kontraktore
- ☐ Përfaqësimin ose angazhimin për dy ose më shumë përfitues me interesa të kundërta në të njëjtën çështje

Përkthuesi në mënyrë të argumentuar faktet dhe rrethanat që lidhen me konfliktin e interesit:

V. MASAT E NDËRMARRA NGA LOBISTI

- ☐ Është njoftuar përfituesi i lobimit
- ☐ Është hequr dorë nga ushtrimi i veprimtarisë së lobimit
- ☐ Janë ndërmarrë veprimet për përfundimin e marrëdhënies kontraktore

VI. DEKLARIM

Deklaroj se informacioni i paraqitur në këtë formular është i plotë, i saktë dhe i vërtetë, sipas dijenisë sime.

Vendi: _____

Data: _____

Emër / Mbiemër

Nënshkrimi
